Projekti i KESH për impiantin fotovoltaik lundrues

Vendi: SHQIPËRIA
Numri i Projektit: 51908
Sektori i Biznesit: Energji EMEA
Lloji i njoftimit: Shtetëror
Kategoria Mjedisore: B
Data e Synuar për Aprovim: 21 Tetor 2020
Statusi: Koncepti i Aprovuar
Data e Publikimit të Dokumentit Përmbledhës së Projektit (DPP) në gjuhën angleze: 20 Korrik 2020

Përshkrimi i Projektit

Deri më 9.75 milionë Euro hua për një kompani të prodhimit të energjisë diellore në Shqipëri, në pronësi të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare ("KESH") sh.a, kompania shtetërore e prodhimit të energjisë elektrike për ndërtimin e një impianti fotovoltaik lundrues mbi liqenin e hidrocentralit të KESH në Vaun e Dejës me një kapacitet të instaluar prej 12.9 MW. Energjia e prodhuar nga impianti diellor do të shitet në tregun e lirë të energjisë.

Objektivat e Projektit

Projekti do të mbështesë zbatimin e një teknologjie lundruese të impiantit fotovoltaik, i pari këtij lloji në Shqipëri dhe në rajon si dhe do të promovojë përdorimin më të gjerë të kësaj teknologjie me qëllim rritjen e kapaciteteve të energjisë diellore në rajon përmes përdorimit eficent të liqeneve ekzistuese. Në të njëjtën kohë projekti do të forcojë performancën operacionale dhe financiare të KESH përmes reduktimit të varësisë nga të ardhurat hidrike dhe përmes ndikimit pozitiv të kësaj teknologjie në nivelin e ujrave të liqenit ekzistues.

Impakti në tranzicion

ETI 65
Impakti në tranzicion vjen nga përfitimet klimatike që sjell ndërtimi i një impianti lundrues të energjisë së rinovueshme me një kapacitet prej 12.9 MW në Shqipëri dhe nga përdorimi i teknologjive të reja e të gjelbra në vend. Projekti do të kërkojë gjithashtu një përdorim minimal të tokës dhe do të ndihmojë në uljen e avullimit nga sipërfaqet e ujit duke sjellë kështu një përdorim eficent të burimeve. Krahas kësaj projekti do të rrisë stabilitetin financiar të kompanisë së vetme të prodhimit të energjisë në vend.

Informacion për Klientin

KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SHA

Huamarrësi do të jetë një kompani e themeluar me qëllimin e vetëm zhvillimin, ndërtimin dhe zbatimin e Projektit. Ajo do të jetë nën pronësinë e plotë të KESH. KESH është lider në prodhimin e energjisë në Shqipëri dhe zotëron tre hidrocentralet më të mëdha në vend që prodhojnë sasinë kryesore të energjisë në përdorim.

Përmbledhja e financimit të BERZH

9,750,000.00 Euro

Deri në 9.75 milionë Euro përmes një huaje për financim projekti e cila do t'i jepet Huamarrësit.

Kostoja Totale e Projektit

13,940,000.00 Euro

Vlera e shtuar

Banka është komplementare përmes financimit dhe minimizimit të riskut. BERZH ofron terma, kushte dhe afate që nuk mund të sigurohen nga burimet komerciale por janë të nevojshme për financimin e Projektit, ndërsa marrëdhënia ekzistuese midis BERZH dhe KESH i jep siguri klientit që të investojë në këtë teknologji të re.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategoria B sipas kritereve të Politikës Mjedisore dhe Sociale të vitit 2019. Problematikat mjedisore dhe sociale që mund të lidhen me projektin pritet të identifikohen, vlerësohen dhe parandalohen bazuar në Vlerësimin Social dhe Mjedisor. Risqet/impakti kryesor në kuadrin social dhe mjedisor të Projektit përfshijnë impaktin që mund të ketë ndërtimi dhe operimi në cilësinë e ujit dhe biodiversitetin ujor dhe tokësor nga Impianti fotovoltaik, lidhja elektrike me nën-stacionin pranë hidrocentralit më të afërt dhe impakti potencial në përdorimet e tjera të liqenit (turizmi, peshkimi, etj). Vendndodhja e projektit të propozuar brenda liqenit është në një zonë kyce të Biodiversitetit dhe përputhshmëria me kriteret e PR6 do të jetë në fokus kryesor. Një vlerësim i vazhdueshëm mjedisor dhe social është duke u ndërmarrë nga një kompani konsulente dhe përfshin verifikim në terren të vendndodhjes së Projektit dhe mbledhjen të dhënave bazë sociale dhe për biodiversitetin e zonës, shqyrtim të statusit të lejimit të Projektit dhe vlerësim të menaxhimit të kapaciteteve Mjedisore dhe Sociale të Klientit. Kjo përfshin një vlerësim të ndonjë habitati kritik apo vecorive kryesore të biodiversitetit sipas rastit. Në bazë të vlerësimit, do të hartohet një Përmbledhje Jo-Teknike që do të publikohet në gjuhen vendase dhe në atë angleze. Dokumenti Përmbledhës i Projektit do të përditësohet pas përfundimit të Vlerësimit Mjedisor dhe Social dhe dakordësimit të një plani masash sociale dhe Plani të Angazhimit të Grupeve të Interesit.

Bashkëpunimi Teknik

Programi i Bashkëpunimit Teknik do të jetë në vlerën 165,930 Euro me fonde të Fondit Special të Aksionerëve (SSF) të Bankës për Vlerësimin Mjedisor dhe Social dhe Vlerësimin Ligjor dhe Komercial. Një program tjeter i
bashkëpunimit teknik prej 74,920 Euro me fonde të qeverisë austriake (fondi Drive) do të alokohet për Vlerësimin Teknik të Projektit.

Informacion për Kontaktimin e Kompanisë

Benet Beci, CEO
benetbeci@kesh.al
+355 4 2259729
www.kesh.al
Rr. Viktor Eftimiu, Blloku Vasil Shanto, Tiranë, Albania

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion tëmëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni këtu.

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni Prokurimet e BERZH: Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH-it.

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

PMS-ja dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZHzbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMSdhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankesave për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit,

veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikat e BERZH në këtë aspekt jepet në PMS.

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZHpromovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZHe shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e Politikës së Qasjes në Informacion për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH..

Mekanizmi i Ankimimit i Projektit (MAP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankesave në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të

Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes mekanizmit të llogaridhënies së BERZH..

Mekanizmi i llogaridhënies shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëm. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të bërjes publike; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me Politikën e vet Mjedisore dhe Sociale apo dispozitat specifike për Projektin të Politikës së vet të Qasjes në Informacion; dhe kur gjen zbatim, trajtojë çdo mospërputhje të verifikuar me këto politika, ndërkohë që parandalon mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit për të paraqitur një ankesë përmes formularit të fshehtë në internet, me postë elektronike, postë apo telefon. Ne jemi të gatshëm t'i diskutojmë shqetësimet tuaja dhe t'i përgjigjemi pyetjeve që mund të keni për ngritjen dhe trajtimin e ankesave. Identiteti i ankimuesve mund të mbahet i fshehtë sipas kërkesës.

Ju lutemi vini re se pas emërimit të Kreut të ri të mekanizmit në vitin 2020, Politika e rishikuar e Llogaridhënies së Projektit dhe Udhëzimet do të hyjnë në fuqi për të udhëzuar trajtimin e çështjeve.